



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria -Vlada-Government*

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural  
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja  
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development

ZYRA PËR KOMUNIKIM ME PUBLIKUN/ KANCELARIJA ZA JAVNO KOMUNICIRANJE/  
/OFFICE OF PUBLIC COMMUNICATION/

THIRRJE PËR APLIKIM  
PËR FERMERËT DHE EKONOMITË BUJQËSORE TË KOMUNAVE:  
PRISHTINË, PRIZREN DHE MITROVICË

PËR PËRFITIM NË KUADËR TË IMPLEMENTIMIT TË PROGRAMIT SPECIAL "ZONAT RURALE MË PAK TË ZHVILLUARA", MBËSHTETJE PRODHIMIT TË QUMËSHITIT DHE MISHIT (LOPËT QUMËSHTORE, DHENTË DHE DHITË) DHE PËRPUNIMI I PRODHIMEVE TË QUMËSHITIT

### **I. Qëllimi i thirrjes për aplikim**

Qëllimi i thirrjes për aplikim është dhënia e ndihmës financiare/granteve për investime në ferma në kuadër të programit special "Zonat rurale më pak të zhvilluara" **mbështetje prodhimit të qumështit dhe mishit (lopët qumështore, dhentë dhe dhitë) dhe përpunimi i prodhimeve të qumështit.**

### **II. Përfituesit e mundshëm**

Përfitues të kësaj mase mund të jenë personat fizik ose juridik, të cilët duhet të jenë:

- Banorë të përhershëm të Republikës së Kosovës;
- Të regjistruar në regjistrin e bizneseve të Kosovës (personat juridik) dhe
- Të regjistruar si fermerë në Regjistrat e Sektorit për Identifikim dhe Regjistrim të kafshëve (I&R) pranë Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinës (AUV);
- Të jenë të regjistruar në regjistrin e fermës;
- Personat fizik, të cilët përfitojnë përkrahje për projekte me vlerë prej 20,000 Euro e më shumë duhet që brenda 10 ditësh nga data e njoftimit që janë përzgjedhur të regjistrojnë ndërmarrjen e tyre.

### **III. Kriteret e pranueshmërisë:**

- 1) Aplikuesit duhet të kenë lopë, dhenë dhe dhi të shënuara me matrikuj të Republikës së Kosovës dhe të posedojnë listën e verifikimit të kafshëve për çdo kokë të lëshuar nga AUV-ja;
- 2) Aplikuesit duhet të kenë së paku 15 (pesëmbëdhjetë) lopë qumështore ose 50 (pesëdhjetë) krerë dele apo dhi në pronësi;
- 3) Aplikuesit duhet të sjellin dëshmi të posedimit të tokës bujqësore dhe atë të paktën 0,5 hektarë/kokë të lopëve qumështore apo 0,05 ha/kokë deleje apo dhie (të pranueshme janë ara, livadhe dhe kullota). Sipërfaqja e tokës duhet të jetë në pronësi apo e marrë me qira për së paku tri vjet;
- 4) Aplikuesit duhet të dëshmojnë ndërtimin e stallës përmes:
  - a) Lejes së ndërtimit, lëshuar nga organi kompetent i komunës;
  - b) Pëlqimit të komunitetit në mjedisin ku planifikohet; ndërtimi i stallës dhe
  - c) Vlerësimi i ndikimit mjedisor, (vetëm nëse ai kërkohet me ligj) pasi të miratohet projekti.Kriteret nga pika 4-të, vlejné vetëm për përfituesit e ndërtimit të stallave të reja.

#### **IV. Investimet e pranueshme për nën-masën e ripërthypësve të imët:**

1. Ndërtimi i stallës së re me dimensione jo më të vogla se 20,40 m x 10,40 m, me këtë infrastrukturë të brendshme:
  - Grazhdet për të ushqyer;
  - Sistemi për furnizim me ujë dhe ujë-pirëset;
  - Vendqëndrimet për kafshë të rritura;
  - Vendqëndrimet për qengja apo keca;
  - Karantina; (ndarje fizike);
  - Dyert ballore - 2 copë;
  - Dyer për dalje emergjente -2 copë;
  - Dritaret me pozicion horizontal;
  - Sistemi i ventilimit
2. Pajisje për ruajtje dhe përpunim të bulmetit, ndërtim dhe renovim të dhomave të qumështit / bulmetit:
  - Dhoma e qumështit / bulmetit (ndërtimi i ri), sipas të dhënave teknike, të cilat do të jenë të specifikuara në udhëzues;
  - Ndërtimi apo renovimi i dhomës së qumështit / bulmetit që përfshinë:
    - a) dyshemenë e shtruar me pllaka;
    - b) mure të veshura me pllaka në lartësi deri 1.8 m;
    - c) furnizim më ujë të pijes, si dhe
    - d) sistem të kanalizimit

### **3. Përmirësimi i infrastrukturës përcjellëse në fermë:**

- Deponi e plehut të stallës, ( për plehun e ngurtë) sipas kritereve të MBPZHR-së dhe
- Deponi për ushqim voluminoz (hangarë).

## **V. Investimet e pranueshme për nën-masën e lopëve qumështore janë:**

### **1. Ndërtimi i një stalle për lopë me dimensione jo më të vogla se 20,40 m x 10,40 m, me infrastrukturë të brendshme si më poshtë:**

- Grazhdet,
- Sistemi i furnizimit me ujë dhe ujë-pirëset
- Vendqëndrimet për kafshë të rritura,
- Vendqëndrimet për viça,
- Dyert ballore- copë 2,
- Dritaret me pozicion horizontal,
- Instalimi i rrjetit elektrik brenda fermës,
- Sistemi i ventilimit,
- Dhoma e qumështit

### **2. Pajisje për mjelje, ftohje, ndërtim dhe renovim të dhomave të qumështit:**

- Sistemi i mbyllur i mjeljes,
- Pajisje për ftohje të qumështit (laktofriz ), me kapacitet, 500, 1000 dhe 2000 l,
- Dhoma e qumështit (ndërtim i ri), sipas të dhënave teknike,
- Renovimi i dhomës së qumështit që përfshinë:
  - a) dyshemenë e shtruar me pllaka,
  - b) mure të veshura me pllaka në lartësi deri 1.8 m.
  - c) furnizim më ujë të pijes.

### **3. Përmirësimi i infrastrukturës përcjellëse në fermë:**

- Deponi e plehut të stallës, (i lëngët dhe i ngurtë)
- Deponi për silazh ( sistemi horizontal) dhe
- Deponi për ushqim voluminoz (hangarë).

## **VI. Dokumentacioni i nevojshëm:**

- Për projektet me vlerë nën 20,000 Euro duhet të dorëzohet projekt-propozimi, i cili përmban: përshkrimin e gjendjes ekzistuese në fermë, përshkrimin e investimeve të nevojshme dhe koston e investimeve;

- Të dorëzohet një plan biznesi i punuar sipas udhëzimeve të MBPZHR-së (për projektet me vlerë mbi 20,000 euro).
- Kopjen e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës (për personat fizik) ose kopjen e regjistrimit të biznesit (për persona juridik), dokumentin i cili vërteton se kush e ka autoritetin që të nënshkruaj për kompaninë;
- Kopjen e llogarisë së vlefshme bankare;
- Dëshminë kadastrale të sasisë së tokës së bujqësore (ara, livadhe dhe kullota) në posedim ose kopjen e kontratës që dëshmon të drejtën e shfrytëzimit (qira) të sipërfaqes së tokës bujqësore së paku për tri vjet pas aplikimit;
- Kopjen e listës së verifikimit të lopëve ose të dhenvë dhe dhive të lëshuar nga Sektori për Identifikim dhe Regjistrim (I & R) në kuadër të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinës (AUV);
- Lejen e ndërtimit lëshuar nga organi kompetent i komunës;
- Pëlqimin e komunitetit në mjedisin ku planifikohet ndërtimi i stallës dhe
- Dëshminë e vlerësimit të ndikimit mjedisor (vetëm nëse ajo kërkohet me ligj).

## **VII. Niveli i mbështetjes**

### **a) për nën-masën e ripërtypësve të imët:**

- Kufiri më i lartë i shpenzimeve të pranueshme të investimit në ndërtimin e stallës sipas pikës 1 është 20.000 €.
- Kufiri më i lartë i shpenzimeve të pranueshme të investimit sipas pikës 2 (Pajisje për ruajtje dhe përpunim të bulmetit) është më së shumti 10.000 €.
- Kufiri më i lartë i shpenzimeve të pranueshme të investimit sipas pikës 3 (infrastrukturës përcjellëse) është më së shumti 10.000 €.

### **b) për nën-masën e lopëve qumështore**

- Kufiri më i lartë i shpenzimeve të pranueshme të investimit në ndërtimin e stallës së re sipas pikës 1 është 25.000 €.
- Kufiri më i lartë i shpenzimeve të pranueshme të investimit nga pika 2 (Pajisje për mjelje, ftohje, ndërtim dhe renovimi të dhomave të qumështit) është 20.000 €.
- Kufiri më i lartë i shpenzimeve të pranueshme të investimit nga pika 3 (për përmirësimin e infrastrukturës përcjellëse) është 10.000€.

**Intensiteti i ndihmës publike për të dy nën-masat është 75% i shpenzimeve të pranueshme**

## **VIII. Shpenzimet e papranueshme janë:**

- shpenzimet e kamatës;

- investimet e financuara nga ndonjë projekt i mëhershëm;
- blerja e tokës apo ndërtesave,
- zëvendësimet/renovimet e thjeshta të ndërtesave apo makinerisë
- humbjet nga këmbimi i valutave;
- tatimet, përfshirë TVSH-në,
- blerjet e pajisjeve të përdorura;
- gjobat, ndëshkimet financiare dhe shpenzimet gjyqësore;
- kontributet në material / mallra
- shpenzimet e amortizimit (zhvlerësimit);
- ndalesat bankare, shpenzimet e garantuesit dhe ndalesat tjera të ngjashme;
- shpenzimet për doganim apo import, apo pagesa tjera

### **IX. Shtrirja gjeografike**

Komunat: **Prishtinë, Mitrovicë dhe Prizren**

### **X. Koha dhe mënyra e marrjes së formularëve për aplikim**

Thirrja për aplikim do të jetë e hapur 45 ditë nga data e publikimit, procedimi i aplikacioneve do të bëhet sipas parimit të kriterëve të përzgjedhjes, të përcaktuara paraprakisht nga MBPZHR-ja.

Data e fillimit të dorëzimit të formularit për aplikim është dita e publikimit të thirrjes për aplikim.

Përfituesi duhet të shkojë në zyrën komunale për bujqësi dhe të marrë dokumentet e nevojshme për të aplikuar.

Me përkrahjen e zyrtarit këshillues komunal ose vet përfituesi bën plotësimin e formularit për aplikim dhe siguron dokumentet e nevojshme.

Formulari për aplikim dhe dokumentet e bashkangjitura duhet të dorëzohen në zyrën komunale për bujqësi çdo ditë pune nga ora 9:00-15:30.

### **XI. Kontaktet dhe pikat (vendet) informuese lidhur me aplikimin**

Kontaktet dhe pikat informuese lidhur me aplikimin mund t'i merrni në komunat përkatëse, gjegjësisht zyrën për bujqësi, nga e hëna deri të premten: prej orës 09:00-15:30;

<b>MBPZHR</b>			
Nga e hëna deri të premten: nga 10:00 <sup>h</sup> -12:00 <sup>h</sup>			
1	Departamenti i Pagesave		038 211 967
<b>Drejtoria Komonale të Bujqësisë</b>			
Nga e hëna deri të premten: nga 09:00 <sup>h</sup> - 15:30 <sup>h</sup> ;			
Nr.	Komuna	Personi kontaktues	Telefoni
1	Prishtinë	Ylli Demolli	044/277-610
2	Mitrovicë	Bedri Bajrami	044/245-821
3	Prizren	Jakup Kastrati	044/217-235

